



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT  
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_ .11.2022

**Lënda:** Përgjigje kërkesës së paraqitur nga Redaksia – Albanian Post

Email- redaksia@albanianpost.com

**TIRANË**

Të nderuar,

Në vijim të emailit të mëparshëm si edhe në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, email i datës 14.09.2022 dërguar Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (Autoriteti) ku i referoheni disa informacioneve të ardhura pranë redaksisë së Albanian Post, raportime të cilat ju bëjnë me dije se dy email-e kanë ardhur pranë Autoritetit, me sinjalizime për përfshirje në strukturat e ish-Sigurimit të Shtetit, të dy politikanëve të nivelit të lartë, I.M. dhe F.Xh., me anë të së cilës kërkon;

- o informacion mbi arsyet se pse rasti i Zotit Xh., ka mbetur në heshtje dhe nuk është trajtuar, po njësoj, si me rastin e Zotit M. (duke parë edhe se çështja e këtij të fundit ka qenë akoma më delikate, parë edhe detyrën e lartë shtetërore që mbante, si President i Republikës), vlerësojmë t’ju informojmë si më poshtë:

Së pari : Ligji nr. 45/2015, përcakton qartë subjektet kërkues që mund të kenë qasje në informacion, në rastin konkret *institucionet kushtetuese apo autoritetit publike për verifikim zyrtarësh që emërohen apo ngrihen në detyrë, dhe kandidatët për deputet/kryetar bashkie apo subjektet politike në rastin e të zgjedhurve*. Ligji përcakton qartë edhe objektin, qëllimin e përdorimit të informacionit, të drejtat e kërkuesve, mbrojtjen e palëve të prekura apo të tretëve, kriteret e përdorimit të informacionit si edhe dispozitat procedurale për mënyrën se si të aksesohet informacioni, sipas dispozitave njohëse dhe kufizuese të ligjit nr. 45/2015.

Bazuar në nenin 26 të ligjit nr. 45/2015, pika 2 “*Institucioni kushtetues dhe autoriteti publik i drejtohet Autoritetit me kërkesë për informim mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit për qëllime të përmbushjes së funksioneve të tij*”.

Në zbatim të dispozitës së mësipërme, Autoriteti vihet në lëvizje për verifikimin e figurës për çdo kandidat vetëm pas një kërkesë të paraqitur nga institucion kushtetues apo autoritet publik, nga subjektet politike/kandidatët për deputetë në Kuvendin e Shqipërisë për qëllime të përmbushjes së funksioneve të tij, **dhe jo kryesisht pra me iniciativë të tij**. Vetëm në kushtet kur është paraqitur një kërkesë për verifikim dhe në masën dhe për qëllimet që e lejon ky ligj, lind detyrimi i Autoritetit që “*t’i përgjigjet çdo kërkesë të institucioneve kushtetuese dhe autoriteteve publike, lidhur me ekzistencën e informacioneve në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit, kur kjo kërkohet në kuadër të vlerësimit, sipas legjislacionit përkatës, të cilësive etike, morale dhe profesionale të kandidatëve për t’u emëruar ose ngritur në detyra*” siç përcakton qartë neni 29 i ligjit nr. 45/2015 i ndryshuar.

Për shtetasin F.Xh., pranë Autoritetit, nuk është paraqitur asnjëherë kërkesë, qoftë nga institucionet e përcaktuara në ligj për verifikim të figures së shtetasit qoftë nga shtetasi.

Sa më sipër, Autoriteti, në mungesë të një kërkesë të paraqitur nga vetë shtetasi apo zyrtari në cilësinë e kërkesit apo të një kërkesë nga institucionet që kanë nevojë të kërkojnë verifikimin e zyrtarit në fjalë, nuk mund të vihet në lëvizje e rrjedhimisht nuk mund të ketë një vendimarrje të Autoritetit për shtetasin.

Së dyti: Në cdo rast që pranë institucionit vjen një informacion apo indicie për figura të ndryshme të jetës politike apo zyrtarë, Autoriteti i orienton të gjithë të interesuarit të ndjekin rrugën ligjore për informim, bazuar në ligjin nr. 45/2015, i ndryshuar, duke plotësuar formularin e miratuar nga Autoriteti për njohje me dokumentin apo informacionin në rrugë ligjore. Edhe në rastin konkret është orientuar dërguesi i emailit të ndjeki rrugën ligjore për informim. Deri tani nga asnjë i interesuar nuk është ndjekur rruga ligjore për sa më sipër.

Së treti: sa i takon çështjes së shtetasit I.M., rasti është krejt i ndryshëm nga ai i shtetasit F.Xh. pasi :

- më herët, vetë Kuvendi ka paraqitur kërkesë duke kërkuar verifikim figure për shtetasin I.M.. Komunikimi me Kuvendin për këtë çështje është bërë në zbatim të ligjit nr. 45/2015 i ndryshuar, duke informuar dhe konfirmuar se shtetasi I.M., disponon certifikatën e pastërtisë së figurës, pra ka një historik të trajtimit të rastit të shtetasit nga ana e Autoritetit, ndërsa për shtetasin F.Xh., nuk ka një të tillë.
- ndryshe nga interpretimet që kanë qarkulluar në media mbi informacionin e përcjellë Kuvendit nga institucioni, edhe pas denoncimit të paraqitur, Autoriteti nuk ka kryer verifikim të figurës, por pas verifikimit të indicies, informoi për ekzistencën e dokumentacionit të identifikuar në fondin arkivor si detyrim ligjor për raportim duke i kërkuar organit më të lartë nga ku buron detyrimi ligjor, Kuvendi i Shqipërisë, në mënyrë që të veprohet për ndryshime të mëtejshme ligjore.

Pikërisht problematikat e ndeshura në vite lidhur me vendim marrjet e këtyre komisioneve, bënë që Autoriteti të paraqiste edhe propozime për ndryshime ligjore në ligjin nr. 45/2015 dhe në ligje të tjera, ndryshime të cilat tashmë janë dekretuar nga Presidenti i Republikës dhe shumë shpejt hyjnë në fuqi.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**Kordinatori i të drejtës për informim pranë Autoritetit**

**L. Cocoli**

**SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

**Në mungesë dhe me Urdhër**

**Drejtori i Informacionit**

**Selami Zalli**